




Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut



Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KOMISIONI PËR HARTIMIN E DRAFT - STATUTIT TË QENDRËS PËR PUNË SOCIALE

Vendi: Mitrovicë

Datë :05.12.2022

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 pika c, të Ligjit Nr.03L-40 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës; në nenin 13 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3, dhe 93, të Statutit të Komunës; nenit 7 pika 1.2, dhe 16 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 Për standardet minimale të konsultimit publike në Komuna; nenin 4 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe 14 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 Për Procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës; bazuar në nenin 7 të Rregullores për Transparencë, kryetari i komisionit për hartimin e Draft - Statutit të Qendrës për Punë Sociale në Mitrovicën e Jugut me anë të secilit rregullohen çështjet e funksionimit të Qendrës për Punë Sociale e cila veprimtarin e vet e kryen në kuadër të Komunës së Mitrovicës së Jugut, në bashkëpunim me Njësinë për Komunikim me Publikun, ORGANIZON:

DISKUTIM PUBLIK PËR

DRAFT-STATUTIN E QENDRËS PËR PUNË SOCIALE ME ANË TË SË CILIT, SYNOHET TË RREGULLOHEN – PËRCAKTOHEN ÇËSHTJET QË NDËRLIDHËN ME FUSHËVEPRIMTARIN E KËTIJ INSTITUCIONI PROFESIONAL TË NIVELIT KOMUNAL

Njoftohen të gjithë qytetarët, grupet e interesit dhe palët tjera të interesuara që të marrin pjesë në **Konsultimin** Publik për Draft - Statutin e Qendrës për Punë Sociale me anë të secilit rregullohen çështjet e funksionimit të këtij institucioni.

Diskutimi publik do të mbahet të hënën më dt. 19.12.2022 në Sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës duke filluar nga ora 14.⁰⁰.

Njëkohësisht të gjithë qytetarët, grupet e interesit dhe të interesuarit tjerë në afatin prej 30 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi të gjitha propozimet, komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe pikëpamjet mund t'i bëjnë përmes e-mail adresës elektronike të Komunës së Mitrovicës komuna.mitrovica@gmail.com si dhe te Kryetari i Komisionit për hartimin e Draft-Statutit z. Gani Mustafa email: gani.n.mustafa@rks-gov.net.

Draft - Statutin e Qendrës për Punë Sociale po ashtu mund ta gjeni të publikuar ne ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut duke klikuar në linkun: <https://kk.rks-gov.net/mitrovicjeejugut/mitrovicce-4/konsultime-publike/>.

Mitrovicë



Kryetari i Grupit Punues

Gani Mustafa